

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8 dhe neni 20 paragrafi 1 alineja 11 dhe nenin 89 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14) dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi 1 alineja 7 dhe nenin 39 paragrafi 1 alineja 11 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale nr. 01-4351/1 nga data 29.08.2014, dhe në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-1783/2 nga data 12.03.2015, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në mbledhjen e 10-të, të mbajtur më 12.03.2015, miratoi

## **DORACAK PËR TË DREJTËN E NJOFTIMIT TË SHKURTË PËR NGJARJE PËR TË CILAT JANË FITUAR TË DREJTAT EKSKLUZIVE PËR EMETIM**

### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Lënda**

1. Me këtë Doracak rregullohet e drejta për njoftim të shkurtër për ngjarje për të cilat ekziston një interes i madh te publiku, të drejtat ekskluzive për emetimin e të cilës i ka fituar radiodifuzerë/t nga Republika e Maqedonisë, dhe përcaktohen mënyrat e qasjes deri te sinjali i atij radiodifuzeri/rëve, respektivisht për sigurimin e incizimeve nga ajo ngjarje.

#### **Qëllimet**

2. Qëllimi i këtij Doracaku është sigurimi i zbatimit të dispozitave të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për realizimin e të drejtës për njoftim të shkurtër, që të mos shkelet e drejta që të informohet opinioni për ngjarjet me interes të madh, për cka cdo radiodifuzer ka të drejta ekskluzive për emetim ose ritransmetim të ngjarjeve të këtilla.

#### **Nacionet**

Nacionet e përdorura në këtë doracak e kanë këtë domethënie:

3. *Njoftim i shkurtër* janë sekuencat e shkurtra me zë dhe/ose video për ngjarje të rëndësishme për opinionin që të mundësohet që publiku i radiodifuzerit sekondar në një vend të caktuar të ketë pasqyrim të mjaftueshëm të aspekteve esenciale të ngjarjes për të cilën një radiodifuzer i caktuar ka të drejtë ekskluzive.

Dedikimi i njoftimeve të shkurta është që të jenë të kyçur në lajmet me termin të rregullt të radiodifuzerëve sekondar, por edhe ajo të mos e pengojë radiodifuzerin primar që të përdor njoftime të shkurta në programet e tyre ose ta përdor në mënyrë tjetër sipas përzgjedhjes së tij.

4. *Ngjarje për të cilën ekziston interesim i madh te publiku* është cilado ngjarje, pa marrë parasysh nëse është e organizuar ose jo, për të cilën radiodifuzeri primar ka fituar të drejtat ekskluzive për emetim televiziv dhe i cili sipas mendimit të një ose më tepër radiodifuzerëve nga vendi i radiodifuzerit primar ose nga vende tjera, është me interes të veçantë për publikun e tyre.
5. *Radiodifuzeri primar* është radiodifuzeri që ka të drejta ekskluzive për emetim të ngjarjes për të cilën ekziston interesim i madh te publiku.

Mund të ketë më shumë se një radiodifuzer primar (p.sh. kur disa radiodifuzer veprojnë si asociacion që të fitojnë të drejta ekskluzive për ngjarje sportive).

6. *Radiodifuzer sekondar* është cilido radiodifuzer (nga vendi i radiodifuzerit primar ose nga ndonjë vend tjetër) që dëshiron të sigurojë informata përmes njoftimit të shkurtër për ngjarje për të cilën ekziston interes i lartë te opinioni, e për të cilën ka të drejtë ekskluzive një radiodifuzer tjetër.
7. *Të drejta ekskluzive* janë të drejtat që i ka fituar me marrëveshje një radiodifuzer nga organizatori i ngjarjes, nga pronari i objekteve ku realizohet ngjarja, nga autorit dhe/ose pronarët tjerë të të drejtave, me qëllim që në mënyrë ekskluzive ta emetojë ngjarjen për një rajon të caktuar gjeografik.
8. *Ngjarje e organizuar për të cilën ekziston interesim i madh te publiku* është cila do ngjarje sportive, kulturore, shoqërore, politike, etj. që është rezultat i vendimit të organizatorit dhe që është i organizuar nga persona juridik ose fizik. Në raste kur qasja e publikut deri te objekti ku realizohet ngjarja është e ndaluar ose e kufizuar (p.sh. për ngjarje të caktuara të mëdha kulturore ose shoqërore), emetimi i tyre përmes televizionit mund të jetë po aq e rëndësishme. Në raste të këtilla, realizimi i të drejtave ekskluzive mund të ketë pasoja të mëdha mbi të drejtën e publikut për qasje deri te informatat.
9. *Ngjarje e paorganizuar për të cilën ekziston interesim i madh te publiku* është ngjarje aktuale, siç janë ato për të cilat zakonisht njoftohet nëpër lajme ose në programe të përditshme informative (p.sh. fatkeqësi, katastrofë natyrore, konflikt i armatosur). Në rastet më të shpeshta, cilido radiodifuzer mund të informojë për ngjarje të këtillë, sepse qasja është e lirë (p.sh. rrjedhja e naftës në det). Në disa raste, qasja deri te ngjarje të paorganizuara për të cilat ekziston interesim i madh është i kufizuar, sepse pronari i objektit ka vendosur ashtu (p.sh. drejtoria e minierës mund të ndalojë qasjen e më shumë se një radiodifuzeri deri te vendi i aksidentit të minierës). Te një kufizim i këtillë mund të vijë edhe si rezultat i vendimit të autoriteteve të miratuar për shkak të arsyeve të sigurisë (p.sh. lejohet që vetëm një radiodifuzer të shoqërojë ekipin shpëtues), ose shaktuesin e ngjarjes (p.sh. kidnapuesit e aeroplanit lejojnë vetëm një radiodifuzer në fluturake gjatë aterimit për arsye teknike).

### **Kushtet për realizimin e të drejtës së informimit të publikut**

10. Me qëllim që ti mundësohet publikut ta realizojë të drejtën e vet për informim, e drejta e pronarit të radiodifuzerit primar duhet të jetë lëndë e kufizimit që janë në pajtim me kushtet e mëposhtme.

## **II. PARIMET E PËRGJITHSHME**

### **Mënyra e qasjes deri te sinjali transmetues**

11. Radiodifuzeri sekondar ka të drejtë për qasje deri te ngjarjet për të cilat ekziston interesim i lartë te opinioni me kushte barabarta, të logjikshme dhe jodiskriminuese.
12. Radiodifuzeri sekondar mund ti qaset ngjarjes për të cilën ekziston interesim i madh te publiku në dy mënyra:
  - Duke e incizuar sinjalin e radiodifuzerit primar me qëllim që të përpiloj njoftim të shkurtër dhe/ose
  - Përmes qasjes deri te vendi i realizimit të ngjarjes me qëllim që të përpilojë njoftim të shkurtër.

### **Përpilimi i njoftimit të shkurtër**

13. Çdo radiodifuzer ka të drejtë, me kushte të barabarta, të sigurojë informata për ngjarje për të cilat ekziston interesim i madh te publiku përmes njoftimit të shkurtër, në pajtim me marrëveshjen me radiodifuzerin primar.
14. Radiodifuzeri sekondar ka të drejtë të zgjedhjes së lirë të sekuencave të shkurta nga sinjali transmetues i radiodifuzerit primar, me ç'rast duhet që së paku ta shënojë burimin e tyre.
15. Kur një ngjarje e organizuar për të cilën ekziston interesim i madh te publiku, organizohet në pjesë, secila pjesë e veçantë konsiderohet si ngjarje e veçantë.
16. Nëse ngjarja e organizuar zgjatë disa ditë, radiodifuzeri sekondar ka të drejtë që çdo ditë të emetojë së paku nga një njoftim.
17. Njoftimi i shkurtër mund të zgjasë më së shumti deri në 90 sekonda.

### **Përdorimi i njoftimit të shkurtër**

18. Njoftimi i shkurtër, i përgatitur nga radiodifuzeri sekondar mund të përdoret vetëm nga ai radiodifuzer dhe i emetuar vetëm në kuadër të programeve informative me termin të rregullt (lajme dhe lajme sportive).
19. Radiodifuzeri sekondar nuk guxon që të bëjë program të tërë ose një pjesë të madhe të atij programi përmes njoftimeve të shkurta për ngjarjen dhe në atë mënyrë të prodhojë programe aktuale - informative.
20. Radiodifuzeri sekondar nuk guxon që të emetojë njoftimin e shkurtër për ngjarje të organizuar për të cilën ekziston interesim i madh te publiku, para se radiodifuzeri primar të fillojë me emetimin e incizimit kryesor të ngjarjes për të cilën i posedon rregullat.  
  
Ky emetim kryesor duhet të realizohet më së voni në terminin e parë kryesor për çdo tërësi të veçantë të ngjarjes së rëndësishme për publikun.
21. Njoftimi kryesor duhet të theksojë emrin dhe/ose të fus logon e radiodifuzerit primar si burim i materialit, në rastet kur njoftimi i shkurtër është i përpiluar nga sinjali i radiodifuzerit primar.
22. Njoftimi i shkurtër që veç më ka qenë i emetuar nuk guxon që të përdoret përsëri, përveç nëse ka lidhje të drejtpërdrejte në mes të përmbajtjes së tij dhe një ngjarje tjetër aktuale.
23. Materiali i përgjithshëm programor origjinal (incizimi nga sinjali ose nga vendi i ngjarjes) që e posedon radiodifuzeri sekondar, e që e ka përdorur për përpilimin e njoftimit të shkurtër, duhet të shkatërrohet pas përpilimit të njoftimit, për çka duhet të njoftohet edhe radiodifuzeri primar.

### **Kushtet financiare**

24. Radiodifuzeri primar nuk duhet ti marrë para radiodifuzerit sekondar për njoftimin e shkurtër, përveç nëse merren vesh ndryshe mes vete.
25. Nga radiodifuzeri sekondar nuk guxon që të kërkohet kompensim financiar për të drejtat e emetimit televiziv.
26. Nëse radiodifuzerit sekondar i lejohet qasje deri te vendi i ngjarjes, organizatori i ngjarjes ose pronari i objektit duhet të ketë mundësi për ti marrë para për të gjitha shpenzimet e domosdoshme që janë paraqitur në mënyrë plotësuese.

### **III. DISPOZITAT PERFUNDIMTARE**

27. Me hyrjen në fuqi të këtij Doracaku, pushon vlefshmëria e Doracakut për të drejtën e njoftimit të shkurtër për ngjarje për të cilat janë fituar të drejtat ekskluzive për emetim ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 133/06).
28. Ky doracak hyn në fuqi në ditën e nesërme nga dita e publikimit në "Gazetë zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

**Agjencia për shërbime  
mediatike audio dhe audiovizuele**

**Kryetar i Këshillit**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Nr. 01-1873/1  
12.03.2015  
S h k u p